



VENDIM

Nr. 101 Datë 07.11.2014

PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “UKKO” SH.A., NE AKTIVITETIN E PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA IMPIANTE FOTOVOLTAIKE ME FUQI 1 MW,

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, VKM-së Nr. 196, datë 02.04.2014 “Për miratimin e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik fotovoltaik të shoqërisë “UKKO” SH.A, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “UKKO” sh.a., për licensim në aktivitetin e prodhimit të energjise elektrike nga Impiante Fotovoltaike me fuqi 1 MW, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për këto aplikim,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “UKKO” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik :Neni 9, pika 4.4.2 (Te dhena për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin) ; Neni 9, pika 4.4.3 (Dokumentacioni teknik dhe grafik) ; Neni 9,

pika 4.4.4 (Dokumentacioni tekniko- ekonomik); Neni 9, pika 4.4.5(Leje nga institucione te tjera),) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “UKKO” sh.a, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Impiante Fotovoltaike me fuqi 1 MW per nje afat 30 vjecar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 101 Datë 07.11.2014

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “UKKO” SH.A., NE AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA IMPIANTE
FOTOVOLTAIKE ME FUQI 1 MW,**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____